



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet më të fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Gjykimi ndaj Pjetër Shalës filloi këtë javë me deklaratat hyrëse që u mbajtën të martën dhe të mërkurën. Z. Shala ngarkohet me përgjegjësi penale individuale për katër akuza për krime lufte: ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje e paligjshme. Ai u vetëdeklarua i pafajshëm në lidhje me të gjitha akuzat.

Më 21 shkurt, Zyra e Prokurorit të Specializuar dhe mbrojtësi i viktimave bënë deklaratat e tyre hyrëse. Më 22 shkurt bëri deklaratën hyrëse Mbrojtja dhe z. Shala bëri një deklaratë të shkurtër pa betim.

Paraqitja e provave në këtë çështje gjyqësore do të fillojë më 27 mars dhe dëshmitari i parë i thirrur nga Prokuroria do të japë dëshmi në atë datë.

Në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerë*, Trupi Gjykses nxori Vendimin e Pestë mbi Pjesëmarrjen e Viktimave, më 15 shkurt, dhe versioni i redaktuar publik doli më 20 shkurt.

Tetëdhjetë e katër parashtues të tjerë kërkesash u pranuan si pjesëmarrës në proces, të cilët do t'i shtohen grupit ekzistues të viktimave në këtë çështje dhe do të përfaqësohen nga i njëjti mbrojtës viktimash. Bashkë me këta, numri i gjithsejtë i viktimave pjesëmarrëse në këtë çështje gjyqësore arrin në 137. Vendimi mbi 10 kërkesa të tjera lidhur me statusin e viktimave pjesëmarrëse, siç shtjellohet në Raportin e Njëmbëdhjetë dhe të Dymbëdhjetë të Zyrës Administrative, nuk ka dalë ende.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 17 shkurt, Trupi Gjykses urdhëroi vazhdimin e paraburgimit të Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit. Në këto vendime, Trupi Gjykses konstatoi se rreziqet që z. Thaçi dhe z. Veseli të pengojnë ecurinë e procesit dhe/ose të kryejnë krime të tjera, ekzistojnë ende dhe nuk mund të zvogëlohen mjaftueshëm me masa alternative përveç paraburgimit.

Dje, Trupi Gjykses në të njëjtën çështje gjyqësore rrëzoi kërkesën e Mbrojtjes së Selimit që i kërkonte caktimin e një seance për paraqitje vijuese të të akuzuarit. Mbrojtja e paraqiti këtë kërkesë pas heqjes së redaktimeve në disa nga pretendimet në Aktakuzë. Trupi Gjykses konstatoi se heqja e redaktimeve nga Aktakuza nuk krijon apo sjell "akuza të reja". Sidoqoftë, Trupi Gjykses vendosi se për hir të drejtësisë, të katër të akuzuarve do t'u jepet mundësia që, nëse dëshirojnë, të ndryshojnë vetëdeklarimin e tyre, pasi të kenë lexuar Aktakuzën tërësisht pa redaktime.

Në çështjen gjyqësore *Salih Mustafa*, Paneli i Gjykatës së Apelit rrëzoi një kërkesë të Mbrojtjes me të cilën kërkoi mospjesëmarrjen e mbrojtësit të viktimave në procesin e apelit. Paneli i Gjykatës së Apelit konstatoi se ekziston bazë ligjore për pjesëmarrjen e viktimave përmes Mbrojtësit në procesin e apelit. Seanca para apelit u mbajt javën e shkuar.





KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

**Informim javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**
N°7/2023
Hagë, 23/02/2023

Pyetje nga gazetarët
Nuk pati pyetje.

